

Syllabusi i lëndës

Lënda: Kurani I

Programi i studimit: Teologji Islame

Niveli; Bachelor

Numri i ECTS kredive: 7

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 101

Fondi i orëve: 3+2

Viti akademik: 2024/2025

Semestri: I-rë

Mësimdhënësi: Dr. Flamur Kasami f_kasami@hotmail.com

Përmbajtja e shkurtër e lëndës

Lënda e Kuranit është një nga lëndët më të rëndësishme në FSI për faktin që Kurani është bazamenti themelor i Islamit .Në lëndën përkatëse përfshihen tri fusha kryesore:Nxënia përmendëshe pjesës- xhuzit të parë të Kuranit. Leximi i drejtë me Kuran të hapur nga Kaptinat e ndryshme si dhe rregullat teorike të leximit të drejtë respektivisht Texhvidi Lënda në fjalë është atraktive si dhe ka karakter interaktiv dhe shpirtëror.

Qëllimi i lëndës:

- Lidhja e studentit me librin e shenjtë Kuranin e madhërisëm , duke lexuar dhe mësuar përmendësh .
- Korrigjimi i studentit gjatë leximit të Kuranit të madhërisëm .
- Njohja teorike mbi rregullat e Texhvidit .
- Njohja e studentit me disa fjalë të panjohura që kalojnë gjatë recitimit.

Rezultatet e pritura

- Avansimi i studentit në aspektin e leximit të Kuranit .
- Njohja e studentit me Texhvid në rrafshin teorik dhe praktik.
- Mësimi përmendësh e një sasi të konsiderueshme nga Kurani i madhërishtëm konkretisht 20 faqe.
- Studentit i mundëson të përshkruaj rregullat e leximit të drejtë të Kuranit të madhërishtëm .
- Aftëson studentin që t'i aftësoj të tjerët me të njëjtat kompetenca pas përfundimit në tërësi me të gjithë semestrat e tij.

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet në formë të ligjëratave, stimulimit të studentëve në diskutime interaktive, duke bërë pyetje dhe analiza në kuadër të ligjëratës së mbajtur. Po ashtu do të shfrytëzohen pajisjet e projektorëve për prezantimin e njohurive në formë të sllajdeve me programin Power Point. Po ashtu do të mbahen seminare dhe ese të ndryshme, të cilat do të prezantohen në mënyrë individuale por edhe grupore, dhe teste të vlerësimit. Dhe të tëra këto do të plotësohen me zbatimin e tyre në praktikë duke i implementuar në lexim-këndimin e studentëve para profesorit. Gjithashtu studentët kanë mundësi që gjatë përgatitjes së lëndës të kontaktojnë me profesorin dhe të marrin udhëzime me qëllim të arritjes së cilësisë dhe rezultateve në mësim dhe sukses të studentëve.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë:

Njohje e studentëve me syllabusin dhe planprogramin e lëndës përgjatë semestrit, si dhe rregullat akademike të mirësjelljes e gjithashtu edhe standardet e vlerësimit. *Lexim:* Kaptina Ali Imran fq 50- 54, *Përmendësh* El-Bekare fq 2-3.

Java e dytë:

Texhvid; Përkufizimi i shkencës së texhvidit. Historiku i kësaj shkence. Dispozita e të mësuarit të shkencës së texhvidit.. *Përmendësh;* Kaptina El-Bekare fq 4. *Lexim;* Kaptina Ali Imran fq 55-59.

Java e tretë: *Texhvid:* Vlera e leximit të Kuranit dhe etiket e leximit të tij. *Përmendësh;* El-Bekare fq 5-6. *Lexim;* Kaptina Ali Imran 60- 64.

Java e katërt: *Texhvid;* Njohja me rivajetin- transmetimin e Hafs nga Asim. Shkallët e leximit.

Përmendësh: El-Bekare fq 7-8, *Lexim:* Kaptina Ali Imran fq 65-69.

Java e pestë: *Texhvid*; Istiadheja dhe Besmeleja.. Përmendësh: El-Bekare fq 9. Lexim: Kaptina Ali Imran fq 70-76.

Java e gjashtë *Texhvid* : Vendartikulimet e shkronjave- مخارج الحروف Përmendësh: El-Bekare fq 10-11. Lexim Kaptina En-Nisa fq 77-81.

Java e shtatë: *Texhvid*; Vazhdim i temës مخارج الحروف Përmendësh: El-Bekare fq 12. Lexim Kaptina En-Nisa fq 82-86.

Java e tetë: *Texhvid*: Cilësitë e shkronjave- صفات الحروف Përmendësh: El-Bekare fq 13. Lexim Kaptina En-Nisa fq 87- 91.

Java e nëntë: *Texhvid*; Vazhdim i temës صفات الحروف . Përmendësh: Kaptina el-Bekare fq 14-15. Lexim Kaptina En-Nisa fq 92-96.

Java e dhjetë:

(Kolekfium)

Java e njëmbëdhjetë *Texhvid*; Rregullat e Nunit Sakin dhe Tenvinit, (Idhhari dhe Idgami).

Përmendësh: El-Bekare fq 16-17. Lexim En-Nisa fq 97-101.

Java e dymbëdhjetë: *Texhvid*; Rregullat e Nunit Sakin dhe Tenvinit (Ihfaja dhe Iklabi).

Përmendësh: El-Bekare fq 18-19.

Java e trembëdhjetë: *Texhvid*: Rregullat e Mim me sukun- أحكام الميم الساكن *Përmendësh: El-Bekare fq 20. Lexim Kaptina En-Nisa fq 102- 106.*

Java e katërbëdhjetë: *Përmendësh kaptina El-Bekare fq 21. Lexim kaptina El-Enam fq 106-111.*

Java e pesëmbëdhjetë: Përmbyllje e semestrit me një përsëritje gjithëpërfshirëse e diskutime interaktive.

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%

Testi i parë 40%

Provimi final 50%

Total 100%

Literatura obliguese:

1. Sllajdet e përgatitura nga profesori i lëndës.
2. El-Munir fi ahkamit-texhvid- grup autorësh, botimi i 22-të, viti 2013, Jordani

Literartura shitesë- sugjeruese

1- Emin Behrami, Shkenca e Texhvidit, Prishtinë 2000